

**IKD: Ministria e Punës
t'i zbatojë aktgjykimet për
pensionet e dyfishta të
kategorive të dala nga lufta**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARTITË MBLIDHEN SOT PËR SEANCËN KONSTITUIVE, ENDE PA NJË MARRËVESHJE POLITIKE

FAQE 3



Kryetarët e subjekteve
parlamentare do të takohen sot (e
premtë) me kryetaren e Kuvendit,
njëherësh ushtruese e detyrës së

presidentes, Albulena Haxhiu, për
përgatitjet e seancës së 6 gushtit.
Njohësit e zhvillimeve politike
vlerësojnë se ende mungojnë sin-

jalet për një marrëveshje që do të
mundësonte krijimin e institucioneve
të reja dhe shmangien e zgjedhjeve
të parakohshme

**AUTORITETET
E KOSOVËS
VAZHDOJNË
RRËNIMIN
E OBJEKTEVE
PA LEJE PRANË
UJMANIT**

F. 2



**CILI ËSHTË ÇMIMI I PARALELIZMIT
NË KOSOVË?**

F. 3



**SHBA-ja E GODET IRANIN PËRSËRI,
PAS SULMIT NË BAZËN USHTARAKE
NË JORDANI**

F. 2

**EVROPA PËRBALLET ME ZJARRE TË
MËDHA, FRANCA DHE SPANJA NËN
PUSHTETIN E FLAKËVE**

F. 2

**KRYEPROKURORI I PROKURORISË
SPECIALE, ISUFAJ: GËRMIMET NË
VARRIN MASIV NË ZUBIN POTOK
MUND TË ZGJASIN, IDENTIFIKIMI
KËRKON KOHË**

F. 7

EKONOMI



**NË PRISHTINË HAPET
"PANAIRI I GRUAS"**

F. 8

**VENDET E PUNËS ME
RREZIKSHMËRI, HOTI: NGA
1 SHTATORI INSPEKTIVE
DIGJITALE DHE MBIKËQYRJE ME
DRONË**

F. 8

SPORT



**DUKAGJINI PËRFUNDON
AVENTURËN EVROPIANE**

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja E GODET IRANIN PËRSËRI, PAS SULMIT NË BAZËN USHTARAKE NË JORDANI

UASHINGTON, 30 KORRIK - Ushtria amerikane ka kryer përsëri sulme në Iran të enjten në mëngjes herët, duke thënë se ato erdhën si pasojë e sulmeve iraniane kundër forcave amerikane në Lindjen e Mesme. Komanda Qendrore e Shteteve të Bashkuara (CENTCOM) njoftoi të enjten se forcat e saj e përfunduan “një valë të fuqishme” sulmesh ndaj Iranit që zgjati më shumë se dy orë. “Kapacitetet e CENTCOM-it goditën dhjetëra shënjestra të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) në Iran, përfshirë qendra të komandës ushtarake, objekte për raketa dhe dronë, pika të mbikëqyrjes dhe mbrojtjes bregdetare si dhe kapacitete detare”, tha ushtria amerikane në një postim në X. Sulmet e reja ndodhën disa orë pasi presidenti amerikan Donald

Trump u zotua se do ta godiste Iranin “shumë ashpër”, pasi Teherani kishte shënjestruar një bazë në Jordani ku janë të vendosur trupa amerikane. Një zyrtar i lartë amerikan kishte konfirmuar më herët për Radion Evropa e Lirë se ushtria amerikane po kryente sulme brenda territorit të Iranit. Mediet shtetërore iraniane raportuan për sulme në disa qytete të provincës jugperëndimore Khuzestan, si dhe në ishullin Qeshm në Gjirin Persik. Sipas CENTCOM-it, forcat e IRGC-së lëshuan të mërkurën disa raketa balistike nga Irani në një përpjekje për një sulm të befasishtë ndaj forcave amerikane në Lindjen e Mesme, duke shtuar se të gjitha raketat iraniane u shkatërruan. Sipas zyrtarëve amerikanë, ky veprim pason një sulm të së martës, kur Korpusi i Gardës



Revolucionare Islamike i Iranit lëshoi pesë raketa drejt një baze ushtarake amerikane në Jordani. Disa orë më vonë, Shtetet e Bashkuara dhe Arabia Saudite goditën milicinë e mbështetura nga Irani në Irak, duke përshkallëzuar tensionet në mbarë rajonin. Trumpi kishte sinjalizuar më

herët të mërkurën se një veprim ushtarak ishte i pashmangshëm. Në një intervistë për “Fox News”, ai tha se Shtetet e Bashkuara do t'i përgjigjeshin me forcë sulmit të pretenduar iranian. Më vonë të enjten, duke folur në Shtëpinë e Bardhë, Trumpi u tha gazetarëve se tani ishte “radha” e ushtrisë amerikane për ta goditur

Iranin. “Ata e dinë se po ndodh. Po na kërkojnë të mos e bëjmë, por ata u përpoqën të na qëllonin mbrëmë”, tha Trumpi. Sulmet e fundit vijnë pas një pauze të shkurtër në operacionet ushtarake amerikane kundër Iranit, pasi Trumpi i pezulloi veprimet e mëtejshme ushtarake gjatë fundjavës për t'u lënë hapësirë bisedimeve të mundshme diplomatike me Teheranin. Rifillimi i veprimeve ushtarake ka rritur frikën për një konflikt më të gjerë rajonal, ndërsa tensionet midis Uashingtonit dhe Teheranit vazhdojnë të përshkallëzohen. Lufta me Iranin nisi më 28 shkurt, kur Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli sulmuan Iranin, ndërsa Teherani u kundërpërgjigj me sulme ndaj Izraelit dhe shteteve të Gjirit që strehojnë baza ushtarake amerikane.

EVROPA PËRBALLET ME ZJARRE TË MËDHA, FRANCA DHE SPANJA NËN PUSHTETIN E FLAKËVE

PARIS, 30 KORRIK - Zjarret masive kanë përfshirë Evropën Jugore, duke shkaktuar një situatë të paprecedentë në Francë dhe Spanjë. Ekspertët paralajmërojnë se kontinenti po hyn në një epokë të re të zjarreve të mëdha, me flakë që përhapen me intensitet ekstrem dhe janë gjithnjë e më të vështira për t'u kontrolluar. Në Francën jugperëndimore

zjarret kanë djegur sipërfaqe rekord toke, ndërsa autoritetet po përballen me vatra zjarri që kanë krijuar edhe fenomene të rralla atmosferike, si retë e formuara nga nxehtësia e flakëve. Ekspertët i përshkruajnë këto zjarre si ndër më intensivët e regjistruara në vend. Në Spanjë disa zona janë përfshirë nga zjarre të mëdha pranë Madridit dhe rajoneve të



tjera, ndërsa mijëra banorë janë detyruar të largohen nga banesat e tyre. Temperaturat e larta, erërat e forta dhe thatësira kanë

krijuar kushte të favorshme për përhapjen e flakëve. Situata e ka detyruar Bashkimin Evropian ta aktivizojë mekanizmin e mbrojtjes civile dhe të dërgojë avionë, helikopterë dhe ekupe zjarrfikëse për t'i ndihmuar Francën dhe Spanjën. Kriza e zjarreve është shtrirë edhe në vende të tjera të Mesdheut, përfshirë Greqinë dhe

Turqinë, ndërsa autoritetet paralajmërojnë se rreziku mund të rritet më tej me vazhdimin e valës së të nxehtit. Shkencëtarët thonë se rritja e temperaturave globale po favorizon periudha më të gjata thatësire dhe zjarre më të shpeshta e më intensive, duke e bërë menaxhimin e tyre një sfidë gjithnjë e më të madhe për Evropën.

TRUMPI REAGON NDAJ RAPORTIT PËR ARMË KINEZE PËR IRANIN: XI E DI QË DO TË ZHGËNJEHESHA

UASHINGTON, 30 KORRIK - Presidenti amerikan Donald Trump ka reaguar ndaj raportimeve se Kina mund ta furnizojë Iranin me pajisje ushtarake për forcimin e mbrojtjes ajrore, duke deklaruar se do të ishte i zhgënjyer nëse një gjë e tillë do të ndodhte. Sipas një raportimi të “Reuters”-it, Irani pritet të marrë deri në 400 lëshues raketash të



mbrojtjes ajrore me shpatull të prodhuara në Kinë. Bëhet fjalë për një marrëveshje që

vlerësohet mes 60 dhe 70 milionë dollarë dhe që do të ishte një nga përpjekjet më të mëdha të Teheranit për t'i rritur kapacitetet e mbrojtjes ajrore me rreze të shkurtër veprimi. I pyetur nga gazetarët në Zyrën Ovale për këtë çështje, Trumpi tha se presidenti kinez Xi Jinping e di që një zhvillim i tillë do ta

zhgënjente. “Ai e di që unë do të zhgënjehesha shumë”, u shpreh Trumpi. Më herët, sipas presidentit amerikan, Xi Jinping e kishte siguruar se Kina nuk do ta furnizonte Iranin me armë. Ndërkohë, Ministria e Jashtme e Kinës ka mohuar raportimet, duke i cilësuar të pabaza. “Raportet përkatëse janë krejtësisht të pabaza. Kina ka

luajtur vazhdimisht një rol në promovimin e paqes dhe përfundimin e konfliktit”, deklaroi Ministria e Jashtme kineze. Raportimet për furnizime të mundshme ushtarake për Iranin vijnë në një kohë tensionesh të larta në Lindjen e Mesme dhe pas përshkallëzimit të përplasjeve mes Teheranit dhe Uashingtonit.

Irani ekzekutoi qindra persona në gjysmën e parë të vitit 2026

Teherani, 30 korrik - Irani ekzekutoi së paku 370 persona nga 1 janari deri më 30 qershor 2026. Sipas organizatës Iran Human Rights, nga 55 personat

e ekzekutuar me akuza që lidhen me sigurinë kombëtare, 18 ishin protestues, 13 ishin të burgosur politikë, ndërsa 12 u akuzuan për spiunazh ose

bashkëpunim me qeveri të huaja. Statistikat përfshijnë vetëm ekzekutimet që janë verifikuar në mënyrë të pavarur nga organizata Iran

Human Rights. Organizata ka marrë raportime për më shumë se 400 ekzekutime të tjera të cilat nuk janë përfshirë në këto të dhëna.



PARTITË MBLIDHEN SOT PËR SEANCËN KONSTITUIVE, ENDE PA NJË MARRËVESHJE POLITIKE

Kryetarët e subjekteve parlamentare do të takohen sot (e premte) me kryetaren e Kuvendit, njëherësh ushtruese e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, për përgatitjet e seancës së 6 gushtit. Ndërkohë, njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se ende mungojnë sinjalet për një marrëveshje që do të mundësonte krijimin e institucioneve të reja dhe shmangien e zgjedhjeve të parakohshme

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 KORRIK - Sot (e premte) mbahet mbledhja e përbashkët e kryetares së Kuvendit, aktualisht u. d. presidente, Albulena Haxhiu, me kryetarët e subjekteve politike. Pikë e rendit të ditës do të jetë përgatitjet për seancën konstituive të Legjislaturës XI të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila është thirrur për datën 6 gusht në orën 10:00.

Bazuar në situatën aktuale, njohësit e zhvillimeve politike thonë se partitë nuk po japin sinjale serioze për arritjen e një marrëveshjeje që do të mundësonte krijimin e institucioneve të reja dhe shmangien e zgjedhjeve. “Deri atëherë mbetet detyrim politik dhe institucional i subjekteve parlamentare që të vazhdojnë dialogun. Dialogun mes tyre askush nuk duhet ta shohë si shenjë dobësie, por si dëshmi e përgjegjësisë demokratike”, tha Haxhiu në një konferencë për medie.

Haxhiu tha se është përgjegjësi e të gjitha partive parlamentare për themelimin e institucioneve të reja, duke shtuar se duhet të shmangen zgjedhjet e reja.

Afati i fundit kushtetues për seancën konstituive ishte 7 gushti.

Sipas aktgjyqimeve të Gjykatës Kushtetuese nga konstituimi i Kuvendit nis edhe periudha 60-ditore, gjatë së cilës deputetët e legjislaturës së re duhet ta zgjedhin presidentin e ri, në të kundërtën vendi shkon sërish në zgjedhje.

Pikërisht për shkak të mosarritjes së konsensusit mes partive muaj më parë, vendi mbajti zgjedhje të parakohshme parlamentare në qershor - të tretat brenda një viti e gjysmë.

Caktimi i datës për seancën konstituive vjen në kohën kur bisedimet për një marrëveshje të mundshme për krijimin e institucioneve mes partisë fituese të zgjedhjeve, Lëvizjes Vetëvendosje, dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës janë pezulluar.

Më 15 korrik, kreu i LDK-së, Lumir Abdixhiku, tha se ishte i detyruar t'i pezullonte diskutimet me kreun e LV-së, njëherësh kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, pasi në LDK ka një nismë për shkarkimin e tij nga kreu i partisë.



Më 10 korrik Kurti u takua ndarazi me Abdixhikun dhe me kreun e Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza. Përderisa Hamza tha pas takimit se partia e tij do të mbetej në opozitë, Abdixhiku shprehu gatishmëri për vazhdimin e takimeve.

Politologu Dritëro Arifi thotë për Radion Evropa e Lirë se në situatën aktuale, partitë politike nuk kanë dhënë sinjale serioze se mund të arrihet një marrëveshje që do të çonte drejt konsolidimit të të gjitha institucioneve të vendit, pas zgjedhjeve të 7 qershorit.

Thelbi i problemit, sipas tij, mbetet çështja e zgjedhjes së presidentit të vendit dhe nëse nuk ka zgjidhje për këtë, vendi shkon sërish në zgjedhje. Sipas tij, për arritjen e një marrëveshjeje, Lëvizja Vetëvendosje, si partia e parë fituese e zgjedhjeve, por edhe tri partitë e tjera, PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca, kanë pasur kohë të mjaftueshme para dhe pas certifikimit të rezultatit zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 8 korrik.

Mundësia eventuale që një marrëveshje tillë të arrihet ndërmjet LV-së dhe LDK, sipas tij, tashmë nuk duket qartë në horizont për shkak të zhvillimeve brenda LDK-së.

Arifi nuk pret që LV-ja të sigurojë, siç e quan ai, një

“marrëveshje normale” me cilëndo nga partitë e tjera shqiptare. “Edhe nëse do të kemi një marrëveshje, me cilëndo parti që mund ta votojë ndonjë president, ajo do të jetë një marrëveshje për kohë të shkurtër. Pra, do të kemi turbulenca derisa partitë të jenë transparente lidhur me ato për të cilat kanë biseduar në takimet e mëhershme”, thekson Arifi për Radion Evropa e Lirë. Teksa PDK-ja ka deklaruar se do të mbetet në opozitë, Aleanca - që ka refuzuar takimin me Kurtin - ka paraqitur disa kushte për bashkëpunim të mundshëm. Ndër kushtet e Aleancës janë që Kosova ta pranojë projektin e gazit amerikan, ndërtimin e një termocentrali me thëngjill dhe disa kushte të tjera që kanë të bëjnë me ekonominë.

Edhe LDK-ja, para se Kurti dhe Abdixhiku të takoheshin, ka përmendur disa kushte, me Abdixhikun që ka thënë se orientimi strategjik i Kosovës, përfshirë gazi amerikan, “janë parakushti i ekzistencës politike” të LDK-së. “Me LDK-në do të mund të bëhej diçka, por nëse punët e brendshme të kësaj partie do të ishin në një nivel tjetër. Por, ashtu siç janë gjërat brenda LDK-së tash, nuk besoj që nga ajo mund ta kemi një përgjigje deri në gusht, madje edhe deri në fund të shtatorit”, thekson Arifi.

Arifi thotë se tash, kur kanë mbetur më pak se dy javë deri në mbajtjen e seancës konstituive të Kuvendit, gjasat për një marrëveshje janë vetëm teorike. “Që nga fillimi, logjika e zhvillimeve është karakterizuar me joseriozitet. Tash jemi, pak a shumë, para një akti të kryer. Po vërehet që nuk ka konsensus, nuk ka marrëveshje, nuk ka bashkëpunim normal”, theksoi Arifi.

Ai shton se barrën dhe përgjegjësinë kryesore për gjetjen e një zgjidhjeje për një marrëveshje me cilëndo prej partive politike, e bart partia fituese e zgjedhjeve, LV-ja, por pa përjashtuar edhe pjesën e përgjegjësisë që kanë partitë e tjera. Sipas tij, nga perspektiva aktuale mundësitë më të mëdha janë që vendi të shkojë në zgjedhje sesa të gjendet një zgjidhje për t'i shmangur ato.

“Në planin afatgjatë zgjedhjet nuk i konvenojnë askujt për asgjë. Në planin afatshkurtër zgjedhjet i konvenojnë zotit Kurti, sepse prapë është kryeministër në detyrë dhe kështu e vazhdon deri në një vendim të radhës...”, thotë Arifi. Arifi beson se LV-ja do të arrijë edhe si parti e vetme, bashkë me deputetët e komuniteteve joserbe, të konstituojnë Kuvendin, madje edhe ta formojë qeverinë.

Më pas, sipas tij,

mosmarrëveshjet për zgjedhjen e presidentit do ta çojnë vendin në zgjedhje të parakohshme dhe vendi do të gjendet në situatën e njëjtë sikurse para zgjedhjeve të 7 qershorit.

Partia në pushtet, LV-ja e Kurtit, sipas rezultatit të certifikuar i ka fituar 53 mandate. PDK i ka fituar 22 ulëse, LDK 18 ulëse dhe Aleanca shtatë ulëse.

Për konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e qeverisë së re nevojiten 61 vota në Kuvendin prej 120 ulësesh.

Partia e Kurtit, së bashku me partitë nga komunitetet pakicë joserbe, i kanë numrat e nevojshme për këto dy procese. Por, për presidentin kërkohet një marrëveshje politike, pasi duhet prania e 80 deputetëve në dy rundet e para të votimit.

Me një marrëveshje të mundshme me LDK-në, e cila i ka 18 deputetë, atëherë do të arriheshin të paktën 81 vota, të mjaftueshme për zgjedhjen e presidentit të ri, nëse të paktën 80 prej tyre do të qëndronin në sallë në dy rundet e para të votimit.

Nëse presidenti nuk zgjidhet brenda 60 ditëve nga dita e konstituimit të Kuvendit, atëherë organi ligjvënës shpërndahet dhe vendi shkon në zgjedhje të reja. Nëse Kosova mban sërish zgjedhje, atëherë ato do të ishin votimet e katërta parlamentare që nga shkurti i vitit të kaluar.



Arben Hoti (RFE/RL)

CILI ËSHTË ÇMIMI I PARALELIZMIT NË KOSOVË?

PRISHTINË, 30 KORRIK - Institucionet paralele të Serbisë në Kosovë, sipas Naim Rashitit, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, janë pasqyrim i një përpjekjeje të planifikuar dhe të qëllimshme të Beogradit për ta ruajtur status quo-në për serbët në Kosovë. Me fjalë të tjera, thotë ai, bëhet fjalë për një përpjekje për ta penguar integrimin e serbëve në shoqërinë dhe sistemin institucional të Kosovës. Rada Trajković, nga Lëvizja Evropiane e Serbëve nga Kosova, çështjen e paralelizmit e lidh me sigurinë, duke thënë se besimi i komunitetit serb në institucionet e Kosovës nuk është zhvilluar, prandaj ky komunitet është mbështetur tek institucionet që ia sigurojnë mbijetesën financiare. Rashiti dhe Trajković i paraqitën këto vlerësime për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë (REL), ku u diskutua për problemet e pushtetit paralel, pas zbulimeve që lidhen me emrin e Snezhana Paunovićit,

ministre për Vetëqeverisje Lokale në Qeverinë e Serbisë.

Rasti i Paunovićit

Duke shqyrtuar bazat publike të të dhënave, REL-i konstatoi se, para se të bëhej ministre në vitin 2025, Snezhana Paunović merrte pagë si deputete, por edhe si drejtoreshë e Institucionit paralele serb Farmaceutik në Pejë të Kosovës. Megjithatë, ky institucion zyrtarisht nuk ekziston që nga viti 2021. Institucioni Farmaceutik i Pejës, me seli në Gorazhdec, u shua më 7 tetor 2021 me vendim të Qeverisë së Serbisë. Kërkesën për fshirjen e tij nga regjistri i institucioneve shëndetësore në vitin 2021 e dorëzoi pikërisht Paunović, tregojnë dokumentet e analizuara nga REL-i. Megjithatë, ajo vazhdoi të merrte pagë si ushtruese e detyrës së drejtoreshës së Institucionit Farmaceutik të Pejës deri më 15 prill 2025, kur u bë ministre. Këtë e tregojnë raportet për të ardhurat dhe pasurinë që vetë

Paunović ia dorëzoi Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit. Gjatë seancës së Kuvendit të Serbisë më 28 korrik, Paunović deklaroi se nuk ekziston vendim i Qeverisë së Serbisë për shuarjen e Institucionit Farmaceutik të Pejës. “Nga viti 2021 ekziston vendimi i Qeverisë për themelimin e Institucionit Farmaceutik Mitrovica e Kosovës dhe propozimi për integrimin e pesë institucioneve farmaceutike në këtë institucion të ri”, tha Paunović. Megjithatë, dokumentacioni publik tregon se Qeveria e Serbisë, në vendimin për themelimin e Institucionit Farmaceutik Mitrovica e Kosovës, ka përcaktuar gjithashtu se Institucioni Farmaceutik i Pejës pushon së funksionuari dhe se institucioni i ri merr përsipër mjetet, pronën, të drejtat, detyrimet dhe punonjësit e tij. Pse po humb besimi në institucione? Trajković thotë se rasti i fundit vetëm sa e thellon mosbesimin e serbëve,

qytetarëve të Kosovës. Ajo e përshkruan qasjen e autoriteteve të Kosovës ndaj tyre si “represive”, por shton se zbulime si ato që lidhen me ministrin Paunović ndikojnë edhe në rënien e besimit të tyre ndaj Beogradit. “Ata po u drejtohen gjithnjë e më shumë disa djemve të lagjes, për të mos thënë strukturave paralele ose grupeve kriminale, për të cilët besojnë se do t’i mbrojnë”, thotë Trajković. Duke folur për mungesën e besimit në institucionet e sistemit, Rashiti vlerëson se sot, në Kosovë, paratë përdoren nga të dyja palët “për të shpërndarë para të gatshme para zgjedhjeve, me qëllim blerjen e mbështetjes”.

Si erdhi deri këtu?

Marrëveshja e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve, të cilën Serbia dhe Kosova e nënshkruan në vitin 2013, parashihet edhe integrimin e institucioneve serbe në sistemin e Kosovës. Menjëherë pas nënshkrimit, përfaqësuesit serbë hynë në

Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, Policinë dhe sistemin gjyqësor. Megjithatë, që nga viti 2022, institucionet u braktisën masivisht për shkak të vendimit të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e automjeteve nga targat serbe në ato të Kosovës, si dhe për shkak të shkarkimit të drejtorit të policisë në veri, i cili refuzoi ta zbatonte këtë vendim. Autoritetet e Kosovës u përgjigjën duke shpallur zgjedhje të jashtëzakonshme në katër komunat veriore, të cilat u bojkotuan kryesisht nga serbët. Si rezultat, u zgjodhën kryetarë komunash të nacionalitetit shqiptar. Pasuan protesta dhe përplasje me forcat e rendit. Në mesin e vitit 2025 u mbajtën sërish zgjedhje, në të cilat serbët u kthyen në institucione, ndërsa procesi i rikthimit në polici dhe gjyqësor ende po vazhdon. Në të njëjtën periudhë vazhdoi mbyllja e institucioneve të financuara nga Serbia, gjë që i vendosi ata që kishin status të dyfishtë - të punësuar në Kosovë dhe në

AUTORITETET E KOSOVËS VAZHDOJNË RRËNIMIN E OBJEKTEVE PA LEJE PRANË UJMANIT

Mitrovicë, 30 korrik - Autoritetet e Kosovës i kanë vazhduar të enjten punët për rrënimin e ndërtimeve, për të cilat thonë se nuk kanë leje, pranë Liqenit të Ujmanit në veriun e banuar me shumicë serbe, bëri me dije për Radion Evropa e Lirë një zëdhënës i policisë.

Rrënimi i shtëpive dhe hoteleve të ndërtuara në tokë publike, e cila administrohet nga Ndërmarrja Publike Hidroekonomike “Ibër-Lepenci”, nisi javën e kaluar, kur u rrëzuan mbi 10 objekte. Zëvendës drejtori i Policisë për rajonin e veriut, Veton Elshani, i tha REL-it të enjten se policia po u ofron mbështetje “Ibër-Lepencit” dhe Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit në zbatimin e vendimit për rrënimet.

As Elshani e as autoritetet nuk kanë dhënë hollësi për numrin e objekteve që pritet të rrënohen gjatë këtij aksioni.

Vazhdimi i rrënimeve po ndodh me gjithë kundërshtinë nga pronarët e tyre dhe thirrjet e bashkësisë ndërkombëtare për pezullimin e tyre.

Për rrënimet e javës së kaluar, pronarët u ankuan se autoritetet e Kosovës nuk i kishin respektuar procedurat ligjore.

Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë tha javën e kaluar se veprimi i institucioneve të Kosovës u ndërmor në kohën



kur banorët kishin nisur procedura gjyqësore kundër vendimit për rrënimet.

Gjykata Themelore në Mitrovicë konfirmoi për REL-in se i ka pranuar tri padi civile kundër ndërmarrjes “Ibër-Lepenc” lidhur me rrënimet.

Për dy nga paditë ajo tashmë e ka hedhur poshtë si të pabazuar propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ndërsa për lëndën e tretë ajo po shqyrton ende nëse do të

caktojë ose jo një masë të tillë. Sipas drejtorit të ndërmarrjes “Ibër-Lepenci”, Faruk Mujka, të dhënat e mbledhura treguan se shumica e këtyre shtëpive ishin ndërtuar gjatë viteve 2019-2020 në tokën e ndërmarrjes.

Mujka kishte thënë këtë muaj gjatë një diskutimi publik se “Ibër-Lepenci” e ka detyrim ligjor ta mbrojë pronën që administron.

Korab Dibra, ekspert ligjor për çështje pronësore, shpjegoi

më herët për REL-in se neni 23 i Ligjit për Pronën Publike shprehimisht përcakton se në pronat në pronësi publike nuk mund të fitohet pronësia përmes parashkrimit fitues si dhe me ndërtimin e objektit në kundërshtim me legjislacionin përkatës që rregullon të drejtën e ndërtimit dhe ndërtimin. “Kjo dispozitë e përjashton mundësinë e fitimit të pronësisë në pronën publike, nëse është ndërtuar pa leje, qoftë edhe me aplikim

për legalizimin e ndërtimeve pa leje”, thotë Dibra.

Dibra shtoi se, në kuptim të ligjit, edhe ndërmarrja “ka të drejtë dhe detyrim ligjor ta mbrojë pronën që administron ndaj çdo cenimi të paautorizuar nga palët e treta”.

Por, sipas tij, ligji përcakton se organi kompetent nuk mund ta kryejë rrënimin, nëse kërkesa për legalizim apo ankesa është ende në shqyrtim.

Serbi - në pozitën që të merrnin paga nga të dyja anët.

Paga nga të dyja anët

Trajković i quan “mizore” kritikën ndaj serbëve që punojnë njëkohësisht në institucionet e Serbisë dhe të Kosovës. “Sidomos duke pasur parasysh gjithçka që kanë përjetuar serbët në Kosovë në periudhën pas luftës. Kur i përjashtoni nga pothuajse të gjitha institucionet, shtrohet pyetja nëse dëshironi një Kosovë shumetnike apo jo. Nëse dëshironi që serbët të mbeten, ata nuk mund të mbijetojnë pa para. Paratë janë shumë të rëndësishme. Në thelb, kështu u krijuan këto institucione, të cilat ishin të mbështetura nga bashkësia ndërkombëtare”, thekson Trajković. “Situata do të mbetet e tillë”, vlerëson Rashiti, duke besuar se nuk mund të ketë relaksim të marrëdhënieve pa ndryshimin e qasjes së Serbisë ndaj marrëdhënieve që ndërton me shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Duke folur konkretisht për paralelizmin institucional, ai

këmbëngul: “Sot paratë përdoren edhe në sistemin politik të Kosovës për shpërndarjen e parave të gatshme para zgjedhjeve, me qëllim blerjen e mbështetjes zgjedhore dhe politike. Sistemi serb e bën këtë në Serbi prej shumë kohësh. Shoqëria nuk ka më besim te institucionet; liderët politikë blejnë mbështetje politike, ndërsa institucionet janë përgjithësisht të dobëta, të pasigurta dhe joefikase”.

Shembuj dhe pasojat

Ndërtimi i pishinës olimpike në Leposaviq, në veri të Kosovës, nisi përmes sistemit të Serbisë pothuajse dy dekada më parë. Megjithatë, pishina nuk është përfunduar as sot dhe në vend të saj ndodhet një gropë betoni. Rasti çoi edhe në ngritjen e një aktakuze për dyshime mbi parregullsi në prokurimin publik.

Spitali në Graçanicë, pranë Prishtinës, prej dy dekadash funksionon në kontejnerë. Fondet për këtë spital i ka ndarë Qeveria e Kosovës.

Megjithatë, pasi institucionet

shëndetësore funksionojnë në sistemin e Serbisë, spitali në këtë pjesë me shumicë serbe nuk është përfunduar kurrë plotësisht dhe as nuk është vënë në funksion të plotë.

Institucionet e Serbisë në Kosovë, vetëm që nga fillimi i vitit 2026, kanë lidhur dhjetë kontrata me kompaninë e Radulle Steviqit, me vlerë mbi një milion euro, edhe pse kjo kompani nuk ka arritur të përfundojë më shumë se njëzet punë të mëparshme në mjediset serbe në Kosovë.

Steviqi është nën sanksione të ShBA-së për lidhje me krimin dhe korrupsionin, ndërsa në Kosovë është nën aktakuzë për dyshime për përfshirje në sulmin ndaj Policisë së Kosovës dhe vrasjen e një polici në Banjskë në shtator 2023.

Tri ndërmarrje në pronësi të Elektroekonomisë së Serbisë (EPS), me seli të regjistruar në Kosovë, kanë borxhe mbi gjysmë miliard euro. Termocentralet Kosova, Minierat Sipërfaqësore Kosova dhe Elektrokosmet renditen ndër 100 humbësit më të mëdhenj në Serbi, sipas raporteve financiare

publike në regjistrin ekonomik serb.

Këto kompani, me adresa fiktive në Kosovë, vazhdojnë të funksionojnë edhe 25 vjet pasi Serbia humbi kontrollin mbi pronën dhe veprimtarinë e sistemit energjetik të Kosovës.

Kosova, sipas ligjit, është e obliguar t’u sigurojë komunave fonde për pagat e punonjësve në arsim dhe shëndetësi. Për shkak të funksionimit paralel të sistemit serb, nuk ekziston kontroll i duhur mbi shpenzimin e këtyre mjeteve, gjë që lë të hapur mundësinë për paga të dyfishta, kontrata fiktive dhe keqpërdorime të mundshme të parave publike. Në shkurt 2024, REL konstatoi se një pjesë e mjeteve ishte shpenzuar në mënyra të dyshimta.

Para se të bëhej ministre në Qeverinë e Serbisë në vitin 2025, Snezhana Paunović merrte pagë si deputete dhe si drejtore të Farmaceutik Pejës në Kosovë, megjithëse ky institucion zyrtarisht nuk ekziston që nga viti 2021.

Në labirintin e paralelizmit

“Disa njerëz, të ashtuquajtur biznesmenë, të cilët ishin nën mbrojtjen e Millan Radoičiqit (i cili pranoi përgjegjësinë për sulmin ndaj policëve të Kosovës në Banjskë), dhe që janë të lidhur me pushtetin në Beograd, kishin privilegjin të merrnin të gjitha punët e mëdha dhe në këtë mënyrë krijuan pasuri. Por bëhet fjalë për një numër të kufizuar njerëzish të lidhur me pushtetin në Serbi”, thotë Trajković, duke komentuar shembujt e mësipërm. “Çdo gjë mund të kishte qenë shumë më mirë”, vlerëson Naim Rashiti, duke shtuar se; “Paralelizmi i bazuar në bashkëpunim ndërinstitucional do të kishte qenë shumë i dobishëm për komunitetet, para së gjithash për serbët e Kosovës. Nuk do të kishte asgjë të diskutueshme nëse njerëzit do të merrnin pensione apo të ardhura shtesë nga Serbia, ndërkohë që do të ruheshin shërbimet kyç, para së gjithash arsimit dhe kultura. Gjithashtu, mund të ishte krijuar një sistem që do t’i mundësonte komunitetit serb të investonte brenda sistemit institucional të Kosovës”, thekson Rashiti.

KISHA ANKOHET PËR PUNIMET NË RRUGËN AFËR MANASTIRIT TË DEÇANIT, KOMUNA THOTË SE JANË MIRËMBAJTJE

DEÇAN, 30 KORRIK - Dioqeza e Rashkës dhe Prizrenit e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë njoftoi se brenda Zonës së Veçantë të Mbrojtur të Manastirit të Deçanit kanë rifilluar punimet në rrugën e transitit ndërkombëtar Deçan - Plavë. Por, nga komuna e Deçanit thanë se bëhet fjalë për mirëmbajtjen e rrugës.

Në njoftimin e Dioqezës thuhet se as Manastiri i Deçanit dhe as Dioqeza nuk janë njoftuar paraprakisht për këto punime e as nuk u është dorëzuar dokumentacioni i projektit apo ndonjë shpjegim lidhur me qëllimin, shtrirjen dhe bazën ligjore të tyre. Por, kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, tha se është kryer një aktivitet dyditor i mirëmbajtjes së rrugës në fjalë, përkatësisht i mbushjes së gropave, largimit të barit dhe shkurreve si dhe largimit të pluhurit të grumbulluar përgjatë rrugës. Ai shtoi se punimet kanë përfunduar dhe se komuna i kishte kryer ato edhe më herët, bazuar në marrëveshjen me igumenin e Manastirit të Deçanit, Sava Janjiq. “U kërkoi të gjithëve mirëkuptim dhe që nevoja për mirëmbajtjen e kësaj pjese të rrugës të shihet në mënyrën e duhur, duke u përmbajtur nga vlerësimet dhe kualifikimet që nuk e pasqyrojnë gjendjen reale”, tha Ramosaj. Në Kosovë, në vitin 2008, u miratua Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, i bazuar në Planin e Ahtisaarit, i cili synon mbrojtjen e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si dhe të pronës së saj. Ky ligj garanton mbrojtjen e manastireve, kishave dhe objekteve të tjera fetare të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si dhe mbron vende të tjera me rëndësi kulturore dhe historike që kanë rëndësi të veçantë për komunitetin serb.



Ndërtimi i rrugës magjistrale Deçan - Plavë është ndërprerë disa herë deri më tani, pasi kalon nëpër Zonën e Mbrojtur. Megjithatë, në vitin 2020 u arrit një marrëveshje për ndërtimin e një traseje anashkaluese rreth Manastirit të Deçanit, përmes Këshillit për Zbatim dhe Monitorim, i cili përbëhet nga përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, Kishës Ortodokse Serbe dhe komunitetit ndërkombëtar. Kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Avdullah Hoti, kishte deklaruar se marrëveshja ishte rezultat i diskutimeve disamujore që ishin zhvilluar në mënyrë konstruktive. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë njoftoi më 29 korrik se Këshilli për Zbatim dhe Monitorim nuk ishte informuar për rifillimin e punimeve në afërsi të Manastirit të Deçanit. Ky këshill përbëhet nga dy ministra të Qeverisë së Kosovës dhe mitropoliti serb, Teodosije, ndërsa në punën e tij marrin pjesë edhe shefat e misioneve të Bashkimit Evropian dhe Organizatës për Siguri dhe

Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë. Dioqeza e Rashkës dhe Prizren tha se shpreson që Policia e Kosovës dhe organet e tjera kompetente do të përcaktojnë pa vonesë “se kush i ka urdhëruar dhe miratuar punimet, do ta verifikojnë bazën e tyre ligjore dhe do t’i ndërmarrin të gjitha masat që janë në kompetencën e tyre për ta siguruar respektimin e ligjit, rendit juridik dhe regjimit të Zonës së Veçantë të Mbrojtur si dhe për t’i ndërprerë punimet e nisura”. Lidhur me këtë rast reagoi edhe Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit, duke deklaruar se çdo veprim që nuk është në përputhje me ligjin dhe procedurat e parashikuara për mbrojtjen e trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore përbën “cenim të drejtpërdrejtë të rendit juridik dhe rrezikon më shumë sigurinë dhe mbijetesën e trashëgimisë së Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë”. “U bëjmë thirrje të gjitha institucioneve

kompetente, si dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë që janë garantues të zbatimit të mekanizmave ligjorë ekzistues, të reagojnë urgjentisht, t’i ndërpresin të gjitha aktivitetet që nuk janë në përputhje me regjimin e Zonës së Veçantë të Mbrojtur dhe ta sigurojnë zbatimin e plotë të ligjit”, u tha në njoftimin e Listës Serbe. Edhe Zyra për Kosovën e Qeverisë së Serbisë reagoi, duke u bërë thirrje përfaqësuesve ndërkombëtarë në Kosovë, që t’i ndalin pa vonesë punimet. Kjo zyrë vlerësoi se këto aktivitete janë qartazi pjesë e “një politike më të gjerë të presionit sistematik ndaj Kishës Ortodokse Serbe dhe besimtarëve të saj” dhe se për këtë arsye po zhvillohen pa asnjë pëlqim apo dijeni të Dioqezës Rashkë-Prizren dhe Manastirit të Deçanit. Në njoftim thuhet se edhe rregulloret e miratuara në Prishtinë nuk po respektohen kur bëhet fjalë për të drejtat e garantuara dhe pronën e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë.

Ndërkaq, Manastirin mesjetar të Deçanit në Kosovë së fundmi e vizitoi pastori Mark Burns, këshilltar joformal i presidentit amerikan, Donald Trump, për çështje shpirtërore. Ai deklaroi për Radion Evropa e Lirë se vërejtjet e tij mbi pozitën e Kishës Ortodokse Serbe dhe liritë fetare do t’ia përcjellë Departamentit Amerikan të Shtetit. Më pas ai shkroi në rrjetin social X se Departamenti Amerikan i Shtetit ka nisur bisedime diplomatike me Serbinë “për ta mbajtur Kosovën përgjegjëse për trajtimin e keq të të krishterëve, përfshirë edhe besimtarët e Kishës Ortodokse Serbe”. Liritë fetare përmenden edhe në Marrëveshjen për Normalizimin Ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e njohur si Marrëveshja e Uashingtonit, e nënshkruar në shtator të vitit 2020 në Shtëpinë e Bardhë, gjatë mandatit të parë presidencial të Trumpit. Në marrëveshje thuhet, ndër të tjera, se të dyja palët angazhohen t’i respektojnë liritë fetare, përfshirë ripërtëritjen e dialogut ndërfetar, mbrojtjen e objekteve fetare dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore që mbrojnë Kishën Ortodokse Serbe. Ndërkohë, Kosova dhe Serbia në vitin 2023 u pajtuan për Aneksin e zbatimit të Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve, në të cilin përmendet formalizimi i statusit të Kishës Ortodokse Serbe. Në të thuhet se “Kosova duhet të sigurojë një nivel shtesë të mbrojtjes për objektet dhe trashëgiminë e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë”. Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve nuk është nënshkruar, por Bashkimi Evropian, i cili ndërmjetëson dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka deklaruar se ajo është juridikisht e detyrueshme për të dyja palët.

Hapja e konsullatës serbe në Shkodër, reagon ministri i Jashtëm Ferit Hoxha

TIRANË, 30 KORRIK - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ferit Hoxha, ka reaguar pas debatit të krijuar nga deklarata e ministrit të Jashtëm të Serbisë për mundësinë e hapjes së një konsullate serbe në Shkodër, duke theksuar se interesi kryesor i Shqipërisë mbetet hapja e një Konsullate të Përgjithshme shqiptare në Luginën e Preshevës. Sipas Hoxhës, Shqipëria ka kërkuar prej kohësh krijimin e një përfaqësie të përhershme konsullore në Luginën e Preshevës, ndërsa Serbia ka paraqitur kërkesën e saj për hapjen e një Konsullate të Përgjithshme në Shkodër. Ai sqaroi se çdo hap do të

ndërmerret vetëm pasi të ketë pajtim mes palëve për të gjitha aspektet e procesit. Ministri theksoi se reciprociteti është një parim themelor i marrëdhënieve diplomatike dhe nuk duhet parë si një barazim mekanik i interesave apo objektivave të dy shteteve. “Synimi dhe interesi i Shqipërisë është të krijojë më në fund një prani konsullore të përhershme në Luginën e Preshevës, një zhvillim i vonuar në një hapësirë ku jeton një komunitet i rëndësishëm shqiptar. Kjo do të na mundësojë të jemi më pranë qytetarëve shqiptarë, t’i mbështesim më drejtpërdrejt dhe t’i mbrojmë interesat e tyre legjitime”, u shpreh Hoxha. Ai kritikoi reagimet që, sipas tij,

janë fokusuar te mundësia e hapjes së konsullatës serbe në Shkodër, duke lënë në plan të dytë përfitimin që sjell për shqiptarët e Luginës së Preshevës krijimi i një përfaqësie diplomatike shqiptare. Në deklaratën e tij, Hoxha nënvizoi se politika e jashtme e Shqipërisë bazohet në interesin kombëtar, respektimin e së drejtës ndërkombëtare dhe vlerave evropiane e jo në emocione apo perceptime. “Ky është standardi ynë sot, por edhe standardi që Shqipëria synon të mbajë si vend i ardhshëm anëtar i Bashkimit Evropian. Ne jemi të vendosur ta përfaqësojmë këtë qasje në çdo vendimmarrje të politikës sonë të jashtme”, përfundoi ministri.




LV-ja dorëzon kallëzim penal ndaj Përparim Ramës dhe zyrtarëve të kabinetit të tij

PRISHTINË, 30 KORRIK - Grupi i Asamblistëve i Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë ka dorëzuar të enjten kallëzim penal në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës ndaj kryetarit të komunës së Prishtinës, Përparim Rama, dhe zyrtarëve të kabinetit të tij, duke

kërkuar hetim të menjëhershëm lidhur me dyshimet për legalizime të jashtëligjshme të objekteve. “Kallëzimi penal bazohet në informacione të pranura nga një sinjalizues, të cilat përmbajnë pretendime serioze për ndërhyrje të paligjshme në

proceset e legalizimit, përfshirje të zyrtarëve komunalë dhe kompanive ndërtimore. Tashmë është përgjegjësi e Prokurorisë Speciale që t'i trajtojë me seriozitet këto pretendime, të verifikojë çdo dëshmi të dorëzuar dhe të ndërmarrë të

gjitha veprimet e nevojshme, në përputhje me ligjin. Qytetarët e Prishtinës meritojnë zhvillim, transpa-rencë dhe llogaridhënie. Çdo dyshim për keqpërdorim të detyrës zyrtare duhet të hetohet në mënyrë të plotë dhe të paanshme”, ka njoftuar LV-ja.



KRYEPROKURORI I PROKURORISË SPECIALE, ISUFAJ: GËRMIMET NË VARRIN MASIV NË ZUBIN POTOK MUND TË ZGJASIN, IDENTIFIKIMI KËRKON KOHË

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 KORRIK - Në fshatin Kalludër të Zubin Potokut në veri të Kosovës, autoritetet janë duke vazhduar gërmimet për mbetje të dyshuara mortore të të zhdukurve nga lufta e fundit. Ndërkaq të enjten kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës, Blerim Isufaj, ka qëndruar për vizitë në Kalludër, në të cilin vend janë gjetur mbetje mortore që dyshohet se u përkasin 23 intelektualëve të zhdukur të Mitrovicës. Isufaj ka deklaruar se procesi i gërmimeve mund të zgjasë dhe se nuk mund të thotë asgjë rreth asaj se kur mund të përfundojë. “Nga mbetjet mortore deri tash është vërtetuar se janë me origjinë njerëzore. Ky proces mund të zgjasë, nuk mund të themi se kur mund të përfundojë. Ajo që ka shumë rëndësi është se identifikimi merr kohë. Mirëpo këto mbetje nuk është se mund të tërhiqen aq lehtë, sepse duhet paraprakisht të konstruktohet trupi i njeriut e pastaj ato duhet të dërgohen në mjekësinë ligjore dhe të vazhdohet me procedura të tjera”, ka thënë ai. Isufaj ka theksuar se Prokuroria Speciale do të zbatojë procedura shumë profesionale, të paanshme, të pavarura me qëllim edhe të respektit ndaj viktimave, por edhe ndaj familjarëve të tyre. “I bëj thirrje gjithë komunitetit në përgjithësi që të mos deklarohemi shumë për rastin, sepse ende gjithçka është herët dhe deklarimet në publik mund ta dëmtojnë procesin e hetimit, natyrisht mund ta devijojnë edhe rezultatin final. Pra, kemi parasysh se është faza preliminare”, ka thënë Isufaj. Edhe ushtruesja e detyrës e presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka vizituar lokacionin në fshatin Kalludër të Zubin Potokut, ku



institucionet e Kosovës po zhvillojnë gërmime në kërkim të personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë. Haxhiu tha se në terren janë të angazhuara institucionet

përgjegjëse për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. “Sot, bashkë me ministren Bogujevci dhe ministrin Hoti, jemi këtu në fshatin Kalludër për të parë nga afër punën e ekipeve tona në kërkim të së vërtetës për

personat e zhdukur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë. Më lejoni që, së pari, t'i falënderoj institucionet e Republikës së Kosovës për përfshirjen në këtë proces, secilin institucion në veçanti:



Policinë, Prokurorinë, Komisionin për Personat e Zhdukur me Dhunë gjatë Luftës së Fundit në Kosovë, Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML), por edhe secilin institucion tjetër që po bën angazhimin maksimal për të ardhur deri tek e vërteta. Ajo që tashmë është konfirmuar është se mbetjet janë me prejardhje njerëzore. Tani duhet të presim punën e institucioneve kompetente për ekzaminimin dhe identifikimin e tyre”, ka thënë ajo. Haxhiu u bëri thirrje institucioneve dhe medieve ta ruajnë integritetin e hetimeve. “Ajo që është e rëndësishme të theksohet është se secili prej nesh, institucionet e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe mediet, duhet të kujdesemi për ruajtjen e integritetit të hetimeve, sepse kjo është një çështje shumë e ndjeshme. Po ashtu, duhet të kemi konsideratë për familjet që presin informacione se çfarë po ndodh në këtë lokacion”, ka shtuar ajo. Haxhiu tha se çështja e personave të zhdukur me dhunë mbetet një plagë e hapur edhe më shumë se 27 vjet pas përfundimit të luftës. “Personat e zhdukur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë janë plaga më e madhe me të cilën po përballemi edhe sot. Pavarësisht se kanë kaluar më shumë se 27 vjet nga lufta, ne vazhdojmë të përballemi me pasojat e saj. Ndërsa këtu po bëhen përpjekje maksimale për ta zbuluar fatin e personave të zhdukur me dhunë. Vazhdojmë të përballemi me gjuhë urrejtjeje, retorikë shoviniste, mohim të krimeve si dhe me pretendime territoriale ndaj Republikës së Kosovës nga krerët e institucioneve në Serbi”, ka deklaruar Haxhiu. Lidhur me këtë zbulim të varrezës masive janë arrestuar dy serbë ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit prej një muaji.

Po vazhdon rehabilitimi i rrugës rajonale Arllat - Malishevë, investimi 1.85 milion euro

PRISHTINË, 30 KORRIK - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Dimal Basha, ka bërë me dije se po vazhdojnë punimet për rehabilitimin e

rrugës rajonale Arllat - Malishevë (R110). Sipas Bashës, projekti përfshin rehabilitimin e rreth 11.7 kilometrave rrugë, me një

investim rreth 1.85 milionë eurosh. Ai theksoi se ky është vetëm një nga projektet që Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit po realizon në

komunën e Malishevës, me synim përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe krijimin e kushteve më të mira për qytetarët.



Në Prishtinë hapet “Panairi i Gruas”

PRISHTINË, 30 KORRIK - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), në bashkëpunim me GIZ-in, ka organizuar në Prishtinë “Panairin e Gruas”, përmes të cilit synohet të mbështeten gratë ndërmarrëse. Aktiviteti mblodhi dhjetëra gra që paraqitën produktet dhe shërbimet e tyre, duke shërbyer si një platformë për fuqizimin ekonomik të grave, promovimin e bizneseve të tyre dhe nxitjen e

bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, sektorit privat dhe partnerëve zhvillimorë. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, ka thënë se pa i ndihmuar gratë qoftë në biznes apo prodhim, Kosova nuk mund të ketë zhvillim të plotë. “Oda Ekonomike e Kosovës në bashkëpunim me GIZ-in kanë organizuar këtë panair për t’i dhënë mundësi edhe komunitetit të grave që

t’i tregojnë produktet e tyre, sepse pas çdo produkti fshihet një inovacion, fshihet një punë e madhe që është bërë për ta krijuar atë produkt. Dhe ne si Odë Ekonomike e Kosovës e vlerësojmë rolin e gruas në zhvillimin ekonomik të vendit. E kemi kuptuar që pa i dhënë hapësirë dhe pa i ndihmuar gratë në biznes, në prodhim, në shërbime dhe në tregti nuk do të mund të kemi zhvillim të plotë”, ka thënë Rafuna.



IKD: MINISTRIA E PUNËS T’I ZBATOJË AKTGJYKIMET PËR PENSIONET E DYFISHTA TË KATEGORIVE TË DALA NGA LUFTA

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi ka shprehur shqetësim për moszbatim të aktgjyqimeve të gjykatës nga Departamentet e Pensioneve - Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ) lidhur me pensionet e kategorive të dala nga lufta. Këto vendime ua njohin qytetarëve të drejtën për pension të dyfishtë. Rastet e trajtuara nga Qendra për Ndihmë Juridike Falas e IKD-së tregojnë se nuk bëhet fjalë për raste të izoluar. Edhe pas përfundimit të procedurave gjyqësore, MPFVLÇ në raste të caktuara nuk i ekzekuton aktgjykimet, nuk i alokon mjetet financiare te qytetarët përfitues të kësaj të drejte ose nxjerr vendime të reja që bien ndesh me atë që ka vendosur gjykata. Sipas IKD-së, në praktikë kjo sjellje manifestohet në forma të ndryshme të moszbatimit të vendimeve gjyqësore. “Në disa raste, edhe kur e drejta është konfirmuar nga të gjitha instancat gjyqësore, përfshirë edhe Gjykatën Supreme, aktgjykimet vazhdojnë të mos ekzekutohen, duke mos u alokuar mjetet financiare për qytetarët përfitues, të

cilët mbesin pa i realizuar përfitimet që u janë njohur me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në raste të tjera, kur gjykata e anulon vendimin administrativ dhe e kthen çështjen në rivendosje, ndërsa Ministria nxjerr përsëri vendim refuzues me të njëjtin arsyetim. Kthimi i çështjes në rivendosje nuk i jep Ministrisë të drejtë ta përsërisë vendimin e anuluar, pa i marrë në konsideratë vërejtjet dhe udhëzimet e gjykatës. Pra, ajo është e obliguar ta respektojë qëndrimin juridik të gjykatës dhe ta shqyrtojë rastin sipas udhëzimeve të saj”, thuhet në komunikatën e IKD-së, duke shtuar se veçanërisht shqetësuese janë rastet kur, pavarësisht se qytetarëve u është njohur e drejta me aktgjyqime të plotfuqishme, Ministria e Punës vazhdon t’ua ndërpresë këtë të drejtë duke nxjerrë vendime të reja të mbështetura në të njëjtat arsye faktike dhe juridike që tashmë janë shqyrtuar dhe refuzuar nga gjykatat. Sipas IKD-së, këto veprime jo vetëm që bien ndesh me autoritetin e vendimeve gjyqësore dhe parimin e res judicata, por krijojnë një situatë ku administrata publike, në vend se t’i zbatojë vendimet e gjykatave, i dety-



ron qytetarët të përballen me procedura të përsëritura administrative dhe gjyqësore për të njëjtën çështje, duke cenuar rëndë sigurinë juridike dhe efektivitetin e mbrojtjes gjyqësore. “Kur me aktgjykim të formës së prerë është njohur e drejta e qytetarit, çështja nuk mund të trajtohet sikur po shqyrtohet për herë të parë. Qytetari nuk duhet të detyrohet të kalojë vazhdimisht nëpër procedura administrative apo gjyqësore vetëm për ta realizuar një të drejtë që tashmë i është njohur nga gjykata. Detyrimi i Ministrisë është ta zbatojë aktgjykimin, jo ta pengojë zbatimin e tij përmes një vendimi tjetër administrativ”, theksohet në komunikatë. IKD-ja ka shtuar se kjo praktikë

cenon sigurinë juridike dhe sundimin e ligjit. Vendimet gjyqësore janë të detyrueshme edhe për administratën publike. “Mbrojtja gjyqësore nuk ka kuptim nëse aktgjykimet mbetet vetëm në letër dhe institucioni kundër të cilit është nxjerrë vazhdon të veprojë në të njëjtën mënyrë. Kur personi zyrtar e di, ose duhet ta dijë, se ekziston një aktgjykim i plotfuqishëm dhe prapë refuzon ta zbatojë atë, veprimi nuk mund të arsyetohet. Neni 394 i Kodit Penal e përcakton si vepër penale refuzimin ose mosekzekutimin brenda afatit të një vendimi apo aktgjykimi të plotfuqishëm gjyqësor. Varësisht nga pasojat, dënimi për këtë vepër penale mund të arrijë deri

në pesë vjet burgim”, thuhet më tutje. IKD-ja ka theksuar se në varësi të qëllimit dhe rrethanave konkrete, këto veprime mund të ngrenë dyshime edhe për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 414 të Kodit Penal. “Kjo vlen veçanërisht kur detyra zyrtare nuk përmbushet ose autoriteti tejkalohet me qëllim që qytetarit t’i shkaktohet dëm apo t’i mohohet një e drejtë. Moszbatimi i këtyre vendimeve u shkakton pensionistëve pasoja të drejtpërdrejta financiare, i detyron të presin me vite dhe krijojnë procedura e shpenzime të panevojshme. Në vend se ta zbatojë ligjin, administrata shndërrohet në pengesë për realizimin e të drejtave të qytetarëve”, shkruhet në komunikatën e IKD-së. IKD-ja kërkon nga MPFVLÇ që t’i evidentojë dhe t’i zbatojë menjëherë të gjitha aktgjykimet e formës së prerë, t’i kryejë pagesat që burojnë prej tyre dhe ta ndalë nxjerrjen e vendimeve në kundërshtim me qëndrimet e gjykatës. IKD-ja kërkon gjithashtu nga Prokurori i Shtetit ta hetojë këtë situatë në kuptim të dyshimeve të ngritura për vepër penale të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

VENDET E PUNËS ME RREZIKSHMËRI, HOTI: NGA 1 SHTATORI INSPEKTIVE DIGJITALE DHE MBIKËQYRJE ME DRONË



PRISHTINË, 30 KORRIK - Ministri i Punës, Andin Hoti, ka njoftuar se nga 1 shtatori Inspektorati Qendror i Punës do të kalojë në inspektive plotësisht digjitale, me synim forcimin e mbikëqyrjes inspektuese dhe rritjen e efik-

asitetit në terren. Sipas tij, sistemi i ri do të mundësojë dokumentim në kohë reale, transparencë më të madhe, llogaridhënie të shtuar dhe monitorim më efikas të inspektiveve. Hoti bëri me dije se njëkohësisht

do të nisë edhe përdorimi i teknologjisë së dronëve si mjet mbështetës për inspektimin e kantierëve dhe vendeve të punës me rrezik të shtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai theksoi se do të iniciohet

forcimi i koordinimit ndërinstitucional në mënyrë që institucionet përgjegjëse të shkëmbejnë informacione në kohë reale dhe mbikëqyrja të jetë më shumë parandaluese sesa vetëm reaguese.

ASK-ja: Vazhdon rënia e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara

PRISHTINË, 30 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar repertorin statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë për muajin maj 2026. Në qershor 2026, numri i ndërmarrjeve të regjistruara pati rënie për (-1,4 %), krahasuar me muajin paraprak (maj 2026).

Ndërsa krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (qershor 2025) pati rënie për (-5,1 %) të ndërmarrjeve të regjistruara, thuhet në raport. Aktivitetet ekonomike më të pëlqyera gjatë këtij muaji ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike dhe

motoçikletave me 242 ndërmarrje të regjistruara, akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 124 ndërmarrje të regjistruara. Në kategorinë “Mikro Ndërmarrje” (0 deri në 9 të punësuar) ishin gjithsej 1 088 ndërmarrje të regjistruara; në

kategorinë “Ndërmarrje të Vogla” (10 deri në 49 të punësuar) ishin gjithsej 4 ndërmarrje të regjistruara. Kurse në kategorinë “Ndërmarrje të Mesme” (50 deri në 249 të punësuar) dhe në kategorinë “Ndërmarrje të Mëdha” (250+) nuk pati ndërmarrje të regjistruara.



SPIUNËT QË TRADHËTUAN MBRETËRESHËN



4 spiunët i përkisnin shtresës së lartë të shoqërisë angleze, por simpatizonin komunizmin: kështu, katër studentë të shkëlqyer të Kembrixhit u rekrutuan nga Bashkimi Sovjetik.

Snobë, të pacipë, idealistë, përfaqësues të shtresës së lartë të shoqërisë angleze, por njëkohësisht tradhtarë pa skrupuj të atdheut dhe të vlerave me të cilat ishin rritur.

Kjo është historia e një grupi spiunësh britanikë në shërbim të Bashkimit Sovjetik, të cilët për gati 20 vjet vepruan në hije, duke vjedhur dokumente të rezervuara dhe duke i kaluar armikut informacione tepër sekrete me vlerë të paçmueshme.

Të quajtur “Cambridge Four” (“Katërshja e Kembrixhit”), sipas universitetit ku studionin, ata kishin të përbashkët një arsimim të shkëlqyer, prejardhje nga shtresa e lartë borgjeze dhe lidhje të jashtëzakonshme. Ata lëviznin në qarqet e diplomacisë, politikës dhe aristokracisë, duke qenë pranë presidentëve, kryeministrave dhe familjes mbretërore, siç shkruhet në artikullin.

Spiunët kundër fashizmit

Historia e spiunëve të Kembrixhit fillon në mesin e viteve 1930, në qytetin universitar të Kembrixhit në Britaninë e Madhe, që në pamje të parë dukej i qetë. Katër nga studentët më të mirë, anëtarë të shoqërisë sekrete me ndikim Cambridge Apostles (“Apostujt e Kembrixhit”), rekrutohen nga shërbimet sekrete sovjetike për shkak të simpative të tyre ndaj komunizmit.

I pari që afrohet është Kim Philby, i cili në vitin 1934 takohet me një ndërmjetës rus në Regent’s Park. Pak më vonë rekrutohen edhe tre të tjerët: Anthony Blunt, Guy Burgess dhe Donald Maclean, të cilët pranojnë të spiunojnë për llogari të Bashkimit Sovjetik. Ajo që i motivon nuk është etja për para, por dashuria për rrezikun, e shoqëruar me një shtysë të fortë idealiste. Të katërt besojnë se vetëm Bashkimi Sovjetik mund ta mposhtë nazizmin dhe se komunizmi është përgjigja ndaj padrejtësive të botës.

Tre prej tyre, Maclean, Philby

dhe Burgess, depërtojnë me sukses në shërbimet sekrete britanike (MI6, Military Intelligence, Seksioni 6, i bërë i famshëm edhe nga filmat e James Bond-it), ndërsa Blunt vazhdon karrierën si historian arti dhe bëhet kujdestar i Koleksionit Mbretëror.

Lojë e dyfishtë

Loja e tyre e dyfishtë është e guximshme. Maclean dhe Philby konsiderohen ndër agentët më të mirë të MI6 dhe u besohen misione gjithnjë e më delikate. Në një moment, Philby madje emërohet drejtues i inteligjencës britanike në Shtetet e Bashkuara dhe dekorohet nga Mbreti George VI me Urdhrin e Perandorisë Britanike. Gjatë viteve, të katërt u kalojnë sovjetikëve informacione jashtëzakonisht të vlefshme. Në Bashkimin Sovjetik mbërrijnë dokumente mbi bombën atomike, Luftën e Koresë, Planin Marshall (të cilin Maclean e quante një mjet amerikan për dominimin ekonomik të Evropës), projektin Venona (një program për

deshifrimin e mesazheve të koduara sovjetike), Luftën Civile Spanjolle dhe kryengritjet komuniste në Shqipëri.

Dalin në dritë dyshimet e para


Shenjat e para që tregonin praninë e një grupi tradhtarësh brenda shërbimeve sekrete dolën në fillim të viteve 1950, pasi disa operacione të Aleatëve dështuan në mënyrë të pashpjegueshme. Në Uashington kërkohej një “nishan” brenda Ambasadës Britanike në Shtetet e Bashkuara. Natyrisht, identiteti i tij i vërtetë nuk dihej, por dihej se përdorte pseudonimin “Homer”. Në të vërtetë bëhej fjalë për Donald Maclean dhe Philby, i vendosur në Uashington, fillon të shqetësohet për mikun e tij. Gjuetia kishte nisur dhe Philby i kërkon Guy Burgess të shkojë në Londër për të paralajmëruar Maclean mbi rrezikun dhe për t’i këshilluar të largohet sa më shpejt. Në verën e vitit 1951, Maclean dezerton dhe arratiset në Bashkimin Sovjetik. Papritur

largohet edhe Burgess, ndoshta nga frika ose ndoshta me urdhër të KGB-së.

Lajmi për zhdukjen e njëkohshme të dy agentëve sekretë shkakton menjëherë tronditje dhe alarm në MI6. Philby përpiket të largojë dyshimet dhe akuzat, por karriera e tij në shërbim të Madhërisë së Saj dëmtohet në mënyrë të parikuperueshme. Nga frika se mos arrestohet, ai transferohet në Liban, ku fillon të punojë si korrespondent për disa gazeta. Ai nuk do t’ia falë kurrë Burgess-it që u arratis në Bashkimin Sovjetik bashkë me Maclean, duke i shkatërruar kështu mbulimin si agent.

Në vitin 1956, Burgess dhe Maclean, të cilët prej pesë vitesh dukeshin sikur ishin zhdukur pa gjurmë, rishfaqen në një konferencë shtypi në Moskë dhe deklarojnë se kanë braktisur Britaninë e Madhe në favor të Bashkimit Sovjetik. Për shërbimet sekrete britanike ky ishte konfirmimi i frikës së tyre më të madhe, ndërsa amerikanët mbetën të tërbuar.

Por është një tjetër dezertor, këtë herë rus, ai që hap ske-



Dy vjet nga medalja e argjendtë olimpike e Distria Krasniqit në Paris 2024

PRISHTINË, 30 KORRIK - Federata e Xhudos e Kosovës ka përkujtuar dyvjetorin e medaljes së argjendtë olimpike të fituar nga Distria Krasniqi në Lojërat

Olimpike Paris 2024. Në një postim në rrjetet sociale, Federata kujtoi se më 28 korrik 2024 Distria Krasniqi i solli Kosovës një tjetër medalje

olimpike, duke vazhduar traditën e sukseseve të xhudos së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Federata vlerësoi edhe kontributin e trajnerit Driton

Kuka, nën drejtimin e të cilit u arrit ky sukses historik. "Një moment krenarie kombëtare", thuhet në postimin e Federatës së Xhudos të Kosovës.



INFANTINO NË RREZIK? EVROPA GJEN KANDIDATIN QË MUND TA RRËZOJË NGA POZITA E PRESIDENTIT TË FIFA-S

ZYRIH, 30 KORRIK - Gianni Infantino ka pësuar goditje në përpjekjen për të qëndruar në krye të FIFA-s, pasi zyrtarët evropianë raportohet se kanë identifikuar kandidatin kryesor për ta sfiduar në zgjedhjet e ardhshme presidenciale. Infantino ka shkaktuar një stuhi reagimesh pas publikimit të planeve për shitjen e aksioneve në operacionet komerciale dhe organizative të FIFA-s, përfshirë edhe Kupën e Botës. Pas raportimeve nga mediet prestigjioze, FIFA konfirmoi se po planifikon të "ftojë palë të treta për të bërë investime minoritare pa të drejtë kontrolli" në një kompani të re të quajtur FIFA Forward Enterprise (FFE), raporton "Telegrafi". Kjo kompani raportohet se mund të ketë një vlerë prej rreth

17.3 miliardë eurosh, ndërsa procesi i investimeve private pritët të udhëhiqet nga Thrive Eternal, një kompani amerikane e kapitalit sipërmarrës e themeluar nga vëllai i dhëndrit të Donald Trumpit, Joshua Kushner. Infantino ka deklaruar se kjo lëvizje ka të bëjë me "demokratizimin e futbollit në mbarë botën" dhe u ka premtuar 211 federatave anëtare të FIFA-s deri në 34.7 milionë euro nëse e miratojnë propozimin kontrovers para afatit të ri. UEFA ka publikuar disa deklarata të forta kundër këtij plani, ndërsa ekzistojnë edhe spekulime se organizata evropiane mund ta bojkotojë Kupën e Botës nëse këto ndryshime zbatohen. Tashmë është bërë me dije se



drejtesit e futbollit evropian e shohin presidentin e PSG-së, Nasser Al-Khelaifi, si kandidatin kryesor që mund ta sfidojë Infantinon për pozitën më të

lartë në futbollin botëror. Al-Khelaifi është kryetar i Qatar Sports Investments dhe i beIN Media Group, por gjithashtu drejton European Club

Association, ndërsa mban poste edhe në Komitetin Ekzekutiv të UEFA-s dhe në Këshillin e FIFA-s. Sipas "Politico", zyrtarët evropianë e konsiderojnë biznesmenin nga Katari si një nga kandidatët më seriozë për ta zëvendësuar Infantinon, i cili po kërkon një mandat të tretë të plotë në mars të vitit 2027, kur do të zhvillohen zgjedhjet e ardhshme presidenciale të FIFA-s. Zvicerani ka drejtuar FIFA-n pa kundërshtar që nga viti 2016 dhe synon të qëndrojë në këtë pozitë deri në vitin 2031. Megjithatë, Al-Khelaifi shihet si një kërcënim i madh për të ardhmen politike të Infantinos në FIFA, ndërsa raportohet se tashmë kanë nisur diskutime mes figurave të rëndësishme të futbollit evropian.

FC VUSHTRRIA PARAQET FANELLAT E REJA PËR SEZONIN E RI, PASON MIQËSORJA NDAJ DINAMOS SË FERIZAJT

VUSHTRRI, 30 KORRIK - FC Vushtrria ka paraqitur zyrtarisht fanellat e reja me të cilat do të paraqitet në sezonin e ri, duke theksuar se ato përfaqësojnë krenarinë, historinë dhe ambiciet e klubit për kampionatin që po afron. Përmes një postimi në rrjetet sociale, klubi bardhekaltër bëri me dije se prezantimi i fanellave shënon një tjetër hap në përgatitjet



për edicionin e ri të Superligës së Kosovës. Pas prezantimit ekipi do të udhëtojë drejt Ferizajt, ku do të zhvillojë ndeshjen e radhës miqësore ndaj FC Dinamos. Ky takim do të shërbejë si një test i rëndësishëm për trajnerin dhe skuadrën, pak javë para nisjes së sezonit të ri. FC Vushtrria e mbylli njoftimin me mesazhin motivues: "Forca Vushtrria!".

DUKAGJINI PËRFUNDON AVENTURËN EVROPIANE

PRISHTINË, 30 KORRIK - KF Dukagjini është eliminuar në raundin e dytë kualifikues të UEFA Conference League pas përballjes me skuadrën zvicerane Lugano.

Pas humbjes minimale 1:0 në ndeshjen e parë në Zvicër, skuadra nga Klina synoi përmbysjen në ndeshjen e kthimit, por Lugano u tregua e fortë dhe triumfoi 5:1 në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Golin e vetëm për Dukagjinin e



realizoi Meris Maliqi, ndërsa për mysafirët shënuan Kevin Behrens (3), Daniel dos Santos dhe një autogol i Egzon Sinanit.

Ancelotti thyen heshtjen dhe zbulon pse i tha 'Jo' ofertës së Italisë

ROMA, 30 KORRIK - Carlo Ancelotti ka zbuluar arsyen pse refuzoi mundësinë për t'u rikthyer në stolin e kombëtares së Italisë, duke zgjedhur ta vazhdojë projektin e tij me Brazilin. Trajneri 67-vjeçar ishte një nga objektivat kryesore të Federatës Italiane të Futbollit (FIGC) pas trazirave të fundit në drejtimin e kombëtares "Azzurre", por vendosi të qëndrojë në krye të Brazilit.

Ish-trajneri i Real Madridit u përfol fuqishëm si kandidati ideal për ta marrë drejtimin e Italisë, ndërsa drejtori teknik i FIGC-së, Paolo Maldini, kishte konfirmuar më herët se Ancelotti dhe Pep Guardiola ishin zgjedhjet kryesore për pozitën e lirë. Megjithatë, negociatat përfunduan në kaos, duke çuar fillimisht në largimin e Maldinit përpara se Claudio Ranieri të emërohej drejtor teknik dhe

Roberto Mancini ta merrte drejtimin e kombëtares italiane. Në një intervistë për ESPN me gazetarin Pedro Ivo Almeida, Ancelotti sqaroi vendimin e tij dhe theksoi se arsyeja nuk kishte të bënte me aspektin financiar apo kontratën. "Nuk është çështje kontrate. Kjo nuk është arsyeja. Është sepse kam një angazhim ndaj CBF-së dhe ndaj këtij vendi, sepse ky vend më ka mirëpritur jashtëzakonisht gjatë

këtij viti të parë. Dua të qëndroj këtu", deklaroi Ancelotti. Trajneri italian gjithashtu falënderoi FIGC-në për interesimin, por insistoi se qëndrimi në Brazil ishte zgjedhja e duhur për shkak të mbështetjes që ka marrë që nga marrja e drejtimin të kombëtares braziliane. "Sigurisht që falënderova Federatën Italiane, por dua të qëndroj këtu sepse besoj se është e drejtë dhe e



ndershme të vazhdoj në një vend që më ka mirëpritur kaq ngrohtësisht dhe në një institucion që më ka dhënë mundësinë për të punuar", shtoi ai.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Golden Gloves” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811891995 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Golden Gloves” D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811891995 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Golden Gloves” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811891995 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “StoneX Holding” Sh.p.k., Suharkë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë “StoneX Holding” Sh.p.k., Suharkë, për Pëlqim Mjedisor për thërrmimin dhe seperimin te gurit gëlqeror, ne Bllacë, Suharekë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.09.2026 në ora 10:00 **Kuvendi Komunal Suharekë**, do të organizohet debat publik nga “StoneX Holding” Sh.p.k., Suharkë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68piZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “StoneX Holding” Sh.p.k., Suharkë, për Pëlqim Mjedisor për thërrmimin dhe seperimin te gurit gëlqeror, ne Bllacë, Suharekë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Loshi Invest” L.L.C , Istog, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun Solar fotovoltaiK “Loshi Energy Farm” me kapacitet 0.60 MW , në Sinajë, Komuna e Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.09.2026 në ora 10:00 në objektin në Shtëpinë e Kulturës “Adem Jashari” komuna Istog, do të organizohet debat publik nga “Loshi Invest” L.L.C , Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68piZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për vlerësimin e ndikimit në mjedis për parkun solar fotovoltaiK “Loshi Energy Farm” me kapacitet 0.60MW" nga kompania “LOSHI INVEST” L.L.C

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

